

Raporti vjetor 2017

Raporti vjetor i Institutit të Statistikave

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Lista e shkurtimeve	3
HYRJE	4
Funksionimi i INSTAT	5
Objektivat strategjikë	8
Koordinimi i Sistemit Kombëtar Statistikor	12
Përmbushja e detyrimeve të PSZ për vitin 2017	15
Aksione të reja statistikore gjatë vitit 2018	20
Strategjia e Cens-it të Popullsisë	23
Cilësia e të dhënave	24
Auditimi i Teknologjisë së Informacionit	30
Indikatorët e PAF	31
Anketa e kënaqësisë së përdoruesve të INSTAT	32
Burimet njerëzore dhe financiare	54
Integrimi Evropian dhe Koordinimi i Projekteve	34
Publikimet 2017	46
Kërkesat e përdoruesve	47
Rrjeti Social Facebook	51
Mbulimi mediatik	53
Kontaktet e institucionit	60

Lista e shkurtimeve

AFP	Anketa e forcave të punës
AKP	Anketa e kostos së punës
ANR	Anketa e ndërmarrjeve të reja
ANJL	Anketa e njërive lokale
APC	Anketa post-census
ASN	Anketa strukturore e ndërmarrjeve
ATN	Anketa tremujore e ndërmarrjeve
BE	Bashkimi Evropian
CAPI	Intervista me kompjuter
CATI	Intervista me telefon
CFCU	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EDP	Procedura e Deficit të Tejkualuar
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIS	Informacioni Gjeo-hapsinor
IÇK	Indeksi i çmimeve të konsumit
IÇP	Indeksi i çmimeve të prodhimit
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti Mbështetës para Pranimit në BE
ISCO	Klasifikimi i Profesioneve
NVE	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike
NJEF	Njësi ekonomike familjare
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SCB	Zyra e statistikave të Suedisë
SIDA	Agjencia Suedeve për Zhvillim

HYRJE

Të dashur lexues,

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor, edhe në vitin që lamë pas, ofroi të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikor.

Viti 2017, ishte një vit inkurajues për INSTAT, ku përmbushja e misionit të tij për të ofruar statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuar, ndihmuan shumë përdorues, institucione publike, kërkues, akademikë, organizata ndërkombëtare dhe lokale si dhe individë të interesuar, për të pasur një pamje sa më afër relitetit ekonomiko-social në vend.

I udhëhequr nga parimet e paanshmërisë, besueshmërisë, përkatësisë, përfitueshmërisë, konfidencialitetit si dhe transparencës, INSTAT ka arritur të ofrojë të dhëna të besueshme, duke rritur cilësinë statistikore. Besoj se respektimi i parimeve dhe standardeve evropiane për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave, ka reflektuar në besueshmërinë dhe paanësinë e të dhënave që INSTAT publikon dhe shpërndan.

Angazhimi ynë maksimal për të rritur efikasitetin e institucionit, duke riorganizuar punën e veprimeve statistikore dhe duke zbatuar metodologjitë më të reja do të sjell arritjen e objektivave të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare.

Rritja e kapaciteteve dhe puna e vazhdueshme e stafit të INSTAT është reflektuar në besueshmërinë e përdoruesëve mbi të dhënat që institucioni publikon. Ne jemi krenar për stafin dhe punën e tyre dhe jemi të vendosur në misionin tonë për të rritur cilësinë statistikore.

Ky raport do t'ju jap një pamje të të gjithë aktiviteteve statistikore dhe performancës së institucionit.



Delina IBRAHIMAJ
Drejtore e Përgjithshme e INSTAT

Funksionimi i INSTAT

Misioni i INSTAT

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni i INSTAT

INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikor.

INSTAT, si burimi kryesor i informacionit statistikor, u përgjigjet kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për vendimmarrje dhe kërkime, duke shpërndarë informacionin statistikor në të njëjtën kohë për të gjithë grupet e përdoruesve.

Gjithashtu, INSTAT ndihmon edhe komunitetin ndërkombëtar të interesuar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor të sigurt dhe të krahasueshëm.

Legjislacioni

Veprimtaria e INSTAT rregullohet me Ligjin Nr.9180, datë 5.2.2004 "PËR STATISTIKAT ZYRTARE", ndryshuar me: Ligjin nr. 21/2012 "Për një ndryshim në Ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikave zyrtare"; dhe me Ligjin nr. 7/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikave zyrtare", i ndryshuar".

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemi Kombëtar Statistikor i të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes

ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në ligj si dhe në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice)¹.

Parimet e statistikave zyrtare

Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane përcakton standarde për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane. Ai është ndërtuar mbi një përkufizim të përbashkët të cilësisë së Sistemit të Statistikave Evropiane (SSE) dhe synon të gjitha fushat e rëndësishme të mjedisit institucional, proceset e prodhimit të statistikave deri në publikimin e statistikave zyrtare evropiane.

Organizimi dhe zbatimi i programit statistikor kombëtar udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) "paanshmëria", që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit;
- b) "besueshmëria", që është karakteristikë e statistikave për të reflektuar sa më mirë që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Ajo nënkupton përdorimin e kriterëve shkencorë për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave;
- c) "pavarësia profesionale", që i referohet personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloj grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore,

¹ <http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-statistics-code-of-practice>

në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor;


ç) "përkatësia", që është mbledhja e të dhënave që kufizohet në atë çfarë është e nevojshme për arritjen e rezultatit të kërkuar;

d) "kosto-efektiviteti", që është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i barrës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultatit të kërkuar;

dh) "konfidencialiteti statistikor", që është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkeljeje të së drejtës së konfidencialitetit. Ajo nënkupton parandalimin e përdorimit jostatistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm;

e) "transparenca", që është e drejta e atyre që përgjigjen të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin janë kërkuar të dhënat dhe masat mbrojtëse të marra.

Organigrama e INSTAT



Përmbledhje e raportit

Koordinimi i Sistemit Kombëtar Statistikor

Në Shkurt të vitit 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Programin e ri pesëvjeçar, nëpërmjet Vendimit nr. 10, datë 09.02.2017 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021”. Për arsye të përfundimit të mandateve, riformatimeve institucionale apo lëvizjeve të përfaqësuesve në pozicione të tjera, Këshilli i Ministrave ka miratuar emërimin e disa anëtarëve të rinj të Këshillit të Statistikave dhe Kryetarit të këtij këshilli.

Përmbushja e detyrimeve të PSZ për vitin 2017

Në Janar të vitit 2017 është miratuar Programi i ri i Statistikave Zyrtare, për periudhën 2017-2021. Gjatë vitit 2017 INSTAT është angazhuar për të realizuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Programit.

Aktivitetet e reja statistikore gjatë vitit 2018

Me qëllim përgjigjen sa më të mirë të kërkesave të përdoruesve si dhe rritjen e cilësisë së produkteve statistikore, për vitin 2018, INSTAT ka ndërmarrë inisiativa të reja në të gjitha fushat e prodhimit statistikor.

Strategjia e Cens-it të Popullsisë

INSTAT ka planifikuar të kryejë CENS-in e ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave në 1 tetor 2020. Për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të tij, INSTAT gjatë vitit 2017 ka filluar të zhvillojë një projekt propozim të Dokumentit të Strategjisë së Cens 2020 që përmban një përshkrim të qasjes, një listë paraprake të aktiviteteve që do të ndërmerren dhe një vlerësim preliminar të buxhetit.

Cilësia e të dhënave

Gjatë vitit 2017, INSTAT përpiloi një sërë dokumentash standarde për menaxhimin e cilësisë, i udhëhequr nga standardet e raportit të cilësisë, bazuar në Sistemin Statistikor Europian. Gjatë vitit 2017 ka filluar puna për hartimin e planit për pilotimin e auditit statistikor.

Auditimi i Teknologjisë së Informacionit

Gjatë 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) zhvilloi një Auditim me fokus auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit. Rekomandimet e lëna nga ky auditim do të zbatohen gjatë 2018 e në vijimësi.

Indikatorët e PAF

Gjatë vitit 2017 INSTAT ka punuar për identifikimin e indikatorë, të cilët do të shërbejnë për matjen dhe vlerësimin e performancës së institucionit, ndërtimin e kalendarit rrotullues të aktiviteteve menaxhuese sipas muajve (PAF wheel), si dhe ka hartuar planin për udhëzuesin e vlerësimit të performancës institucionale.

Anketa e kënaqësisë së përdoruesve të INSTAT

Përdoruesit e të dhënave të INSTAT ishin më shumë femra (53,1 %). Pjesa më e madhe e përdoruesve (49,2 %) i përkisnin grupmoshës nga 21-30 vjeç. Mosha mesatare e përdoruesve është 33 vjeç. Rreth 92,8 % e përdoruesve kishin një diplomë universitare, 26,8 % e përdoruesve ishin student dhe grupi i dytë më i madh i përdoruesve ishin kërkues shkencor (23,4 %).

Integrimi Evropian dhe Koordinimi i Projekteve

Gjatë vitit 2017, janë kryer një sërë aktivitete të parashikuara por edhe të tjera që kanë lindur sipas nevojave të veprimtarisë së Institucionit, në zbatim të objektivave dhe planit të punës.

Publikimet 2017

Gjatë vitit 2017, janë botuar: Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve Ekonomike, 2015; Tregtia e Jashtme, 2012 – 2016; Tregu i Punës, 2016; Regjistri i Ndërmarrjeve, 2016; Burra dhe Gra në Shqipëri, 2017; Tregtia e jashtme sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, 2012-2016; Shqipëria në Shifra, 2016; Vjetari Statistikor Rajonal, 2017; Vjetari Statistikor 2017; Bizneset e Huaja në Shqipëri, 2014-2016; Llogaritë rajonale në Shqipëri, 2015.

Kërkesat e përdoruesve

Databaza e përdoruesve u krijua për herë të parë në vitin 2009. Gjatë vitit 2017 vihet re një rritje e numrit të kërkesave nga përdoruesit në 776 kërkesa nga 509 kërkesa që ka patur në vitin 2016 (267 kërkesa më shumë).

Rrjeti Social Facebook

Gjatë vitit 2017, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 4.497 pëlqime (në 2016 ishte 3590). Ku vlerën më të madhe e arrit gjatë muajve Nëntor - Dhjetor 2017. Nga numri total i pëlqimeve, 57 % janë femra dhe 42 % janë meshkuj.

Mbulimi mediatik

Gjatë vitit 2017, në media të ndryshme, INSTAT është shfaqur 3.571 herë. Tematika më e përmendur në media është Llogaritë Kombëtare me 394 herë, ndjekur nga çmimet 320 herë, tregu i punës me 288 herë etj.

Burimet njerëzore dhe financiare

Në bazë të strukturës së re organizative, Instituti i Statistikave përbëhet nga 2 Koordinatorë, (Koordinatori i Sistemit Kombëtar Statistikor dhe Koordinatori për Cilësinë Statistikore), 9 drejtori, Sektori i Auditit të Brendshëm dhe 12 Zyrat Rajonale të Statistikave. Struktura e re organizative ka në total 216 punonjës, 166 punonjës qendër dhe 50 punonjës në Zyrat Rajonale. Buxheti i Institutit të Statistikave për vitin 2017 i miratuar me ligjin nr.130/2016 është 396.600 mijë lekë. Institutit të Statistikave i janë akorduar fonde shtesë në shumën 67 milion lekë për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore. Buxheti total i Institutit të Statistikave është 484.278 mijë lekë.

Objektivat strategjikë

INSTAT mbështetur në objektivat e PSZ 2017-2021, gjatë vitit 2017 ka punuar për të realizuar:

1. Prodhimin e statistikave sa më cilësore, të kuptueshme dhe të besueshme për përdoruesit, duke e shoqëruar çdo statistikë me prodhimin e treguesve të cilësisë dhe hartimin e raportit të cilësisë. Ndërtimin e metadatave për çdo aktivitet statistikor në formë standarde dhe publikimin e tyre në faqen e web të INSTAT.
2. Ofrimin tek përdoruesit të treguesve të rinj dhe produkteve të reja statistikore. Përmirësimi i treguesve ekzistues dhe respektimi i afateve kohore, do të jenë disa prej orientimeve kryesore për vitin në vazhdim.
3. Përmirësimin e teknikave të grumbullimit të informacionit statistikor duke përdorur metoda moderne si CAPI të cilat shkurtojnë kohën e kapjes dhe përpunimit të të dhënave, dhe të përmirësojnë afatet e publikimit të tyre.
4. Respektimin e afateve të përcaktuara në kalendarin e botimeve të publikuar në faqen e INSTAT: www.instat.gov.al.

Koordinimi i Sistemit Kombëtar Statistikor

Mbështetur në nenin 2/c të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, Sistemi Kombëtar Statistikor është tërësia e institucioneve dhe organizatave që ushtrojnë aktivitet brenda Republikës së Shqipërisë, të cilat mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika zyrtare sipas programit. Sipas nenit 7 të këtij ligji, INSTAT është përgjegjës për koordinimin e funksionimin e këtij sistemi, duke u fokusuar kryesisht në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencive statistikore, planifikimin e programeve zhvillimore dhe monitorimin e ecurisë së tyre, përmirësimin e uniformitetit të metodologjive, mbështetjen teknologjike, zbatimin e parimeve statistikore etj.

Në vitin 2017, Sistemi Statistikor përbëhet nga INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Për të përmbushur detyrat që rrjedhin nga ky ligj, gjatë vitit 2017 INSTAT është fokusuar në përmbushjen e rekomandimeve të BE dhe Eurostat për rritjen e performancës së sistemit nëpërmjet forcimit të kornizës ligjore mbi të cilën funksionon Sistemi Kombëtar Statistikor dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional për të përmirësuar cilësinë e të dhënave administrative që krijohen, zhvillohen dhe transmetohen.

Korniza ligjore

Në Shkurt të vitit 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Programin e ri pesëvjeçar, nëpërmjet Vendimit nr. 10, datë 09.02.2017 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021”. Programi i ri i statistikave zyrtare është dokumenti kryesor mbi të cilën bazohen veprimtaritë e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare gjatë pesë viteve të ardhshme. Programi përcakton institucionet prodhuese të statistikave, njësitë që detyrohen të ofrojnë të dhënat administrative etj, metodologjinë e prodhimit dhe frekuencën e publikimit të tyre.

Në katërmujorin e fundit të vitit 2017 INSTAT ka paraqitur pranë Këshillit të Ministrave projektligjin e ri “Për statistikat zyrtare”, i cili forcon Sistemin Kombëtar Statistikor, rolin e INSTAT si koordinator i këtij sistemi, mandatin e prodhuesve të statistikave zyrtare për të drejtën e hyrjes dhe përdorimit të të dhënave administrative që mbahen nga institucionet publike si dhe pavarësinë profesionale të institucioneve prodhuese dhe stafeve të tyre.

Gjithashtu, ligji i ri për statistikat zyrtare parashikon pozicionimin e INSTAT si institucion i pavarur, i cili i raporton Kuvendit, rformatimin e Këshillit të Statistikave dhe rolit të tij nga vendimmarrës në këshillimor, autonomi më të zgjeruar për administrimin e të ardhurave që krijon INSTAT nëpërmjet shërbimeve statistikore për të tretët, ngritjen e Qendrës së Trajnimit Statistikor si instrument për rritjen e kapaciteteve profesionale të statisticienëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar për statistikat zyrtare.

Ligji i ri “Për statistikat zyrtare” parashikohet të miratohet brenda gjashtëmuajt të parë të vitit 2018. Pas miratimit të tij, një sërë aktesh të tjera nënligjore planifikohet të miratohen për të rregulluar proceset e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, mënyrën e tarifimit të shërbimeve statistikore dhe administrimit të të ardhurave të krijuara, etj.

Një akt tjetër mjaft i rëndësishëm për të garantuar pavarësinë profesionale të INSTAT dhe institucioneve përbërëse të sistemit është edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 650, datë 10.11.2017 “Për angazhimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e besimit në statistika”. Ky vendim konfirmon vullnetin e qeverisë shqiptare për të mbështetur INSTAT dhe prodhuesit e tjerë statistikorë në përmirësimin e pavarësisë profesionale të tyre dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për mbulimin e aktiviteteve statistikore.

Për arsye të përfundimit të mandateve, rformatimeve institucionale apo lëvizjeve të përfaqësuesve në pozicione të tjera, Këshilli i Ministrave ka miratuar emërimin e disa anëtarëve të rinj të Këshillit të Statistikave dhe Kryetarit të këtij këshilli, nëpërmjet VKM nr. 576, datë 13.10.2017, VKM nr. 577, datë 13.10.2017 dhe VKM nr. 758, datë 20.12.2017.

Këshilli i Statistikave përbëhet nga:

Kozeta Sevrani	Kryetar
Majlinda Dhuka	Anëtar
Adrian Kamenica	Anëtar
Nikolla Lera	Anëtar
Rudina Lilaj	Anëtar
Engjëll Skreli	Anëtar
Vilma Nushi	Anëtar

Memorandume mirëkuptimi

Për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në interes të përmirësimit të statistikave zyrtare, besueshmërisë së publikut në to dhe rritjes së imazhit të institucioneve prodhuese, gjatë vitit 2017 INSTAT ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi e mirëkuptimi me institucione të tjera të cilët mbajnë të dhëna administrative, si dhe aktorë të tjerë nga bota akademike, etj. Me nënshkrimin e marrëveshjeve, palët dakordësohen për shkëmbimin e të dhënave që disponojnë duke respektuar parimet e konfidencialitetit statistikor dhe kuadrin ligjor mbi të cilat e ushtrojnë veprimtarinë institucionet përkatëse. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjes, palët shprehin vullnetin për të zhvilluar aktivitete e projekte të përbashkëta për rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve, përfshirjes së stafit në proceset e mbledhjes, përpunimit dhe prodhimit statistikor, etj. Gjithashtu, për të siguruar zbatimin e mdhur të marrëveshjes, palët dakordësohen për ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës, të cilët jo vetëm do të kujdesen për zbatimin e marrëveshjes, por edhe për të propozuar ide apo veprime të tjera në interes të përmirësimit të cilësisë statistikore. Lista e memorandumeve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet INSTAT dhe institucioneve të tjera është si vijon:

Institucioni nënshkrues me INSTAT	Data e nënshkrimit
Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	11.04.2017
Instituti i Sigurimeve Shoqërore	18.04.2017
Qendra Kombëtare e Biznesit	08.05.2017
Shërbimi Social Shetëror	06.06.2017
Ministria e Mbrojtjes	13.06.2017
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	02.06.2017
Ministria e Kulturës	14.07.2017
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	13.09.2017
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	27.09.2017
Shërbimi Kombëtar i Punësimit	30.03.2017
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	17.11.2017
Fondi i sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	20.12.2017

Përmbushja e detyrimeve të PSZ për vitin 2017

Në Janar të vitit 2017 është miratuar Programi i ri i Statistikave Zyrtare, për periudhën 2017-2021. Gjatë vitit 2017 INSTAT është angazhuar për të realizuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Programit. Ndër aktivitetet kryesore të realizuara janë:

Produktet statistikore në fushën ekonomike

- Prodhimi i PBB me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, paraprak 2015, gjysmëfinal 2014 dhe final 2013;
- Prodhimi i PBB sipas rajoneve statistikore, për vitin 2015;
- Hartimi i tabelave burim-përdorime, për vitin 2014, si dhe tabelave të Njoftimit të Deficitit të Tejkualuar (EDP) në përputhje me ESA 2010.
- Prodhimi i treguesve tremujorë të PBB-së me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, Tr4-2016, Tr1-2017, Tr2-2017, Tr3-2017;
- Prodhimi i statistikave të indeksit të çmimeve të konsumit dhe atij të harmonizuar;
- Prodhimi i statistikave të çmimeve të prodhimit, ndërtimit, importit;
- Prodhimi i statistikave mbi lejet e ndërtimit;
- Prodhimi i bilancit të energjisë elektrike, me prriodicitet gjashtëmuor dhe vjetor;
- Prodhimi i statistikave të tregtisë së jashtme;
- Prodhimi i statistikave mbi lëvizjen e shtetasve;
- Prodhimi i statistikave të turizmit;
- Prodhimi i statistikave të transportit (hekurudhor, detar dhe ajror);
- Prodhimi i statistikave mbi aksidentet rrugore;
- Publikimi i Listës së Institucioneve Publike.

Për prodhimin e këtyre treguesve dhe të tjerë, janë kryer një sërë vrojtimesh, si:

- Vrojtimi për matjen e fuqisë blerëse;
- Vrojtimi muor për matjen e çmimeve të konsumit;
- Vrojtimi tremujor i ndërmarrjeve;
- Vrojtimi për strukturën e ndërmarrjeve;
- Vrojtimi për regjistrin e ndërmarrjeve.

Gjithashtu, INSTAT ka kryer edhe një sërë aktiviteteve të tjera, të cilat nuk janë parashikuar në PSZ, por kanë ndikuar në sasinë dhe cilësinë e produkteve statistikore, për të rritur gamën dhe kënaqësinë e përdoruesve për këto produkte, si:

- Publikimi i statistikave të ndërmarrjeve të vogla e të mesme për vitin 2015;
- Publikimi i statistikave të bizneseve të huaja në Shqipëri, për periudhën 2014-2016;
- Kryerja e vërtetimit mujor të turizmit për njësitë akomoduese dhe të ngjashme me to.

Produktet statistikore në fushën e statistikave sociale

- Prodhimi i treguesve të popullsisë dhe strukturës për grup-moshë dhe qarqe, për vitin 2016, si dhe të treguesve të statistikave demografike
- Prodhimi i treguesve të lindjeve, vdekjeve dhe migracionit të brendshëm e të jashtëm;
- Prodhimi i treguesve të arsimit sipas ISCED 2011 dhe treguesve për institucionet arsimore publike e private;
- Prodhimi i treguesve mbi kujdesin shëndetësor dhe analiza e statistikave të shëndetit publik;
- Prodhimi i treguesve mbi shkaqet e vdekjeve në Shqipëri;
- Prodhimi i treguesve të tregut të punës, punësimit, papunësisë dhe pagat, me periodicitet tremujor dhe vjetor;
- Llogaritja e nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të njësisë ekonomike familjare;
- Prodhimi i treguesve të kulturës;
- Prodhimi i treguesve të krimeve.

Për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj kategorie, janë kryer një sërë vërtetimesh, si:

- Vërtetimi “Studimi i Demografisë dhe Shëndetit në Shqipëri”;
- Vërtetimi “Anketa e Forcave të Punës 2016”
- Vërtetimi “Anketa e Kostove të Punës”
- Vërtetimi “Anketa e Buxhetit të Familjes 2016”

Gjithashtu, për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj kategorie, janë kryer edhe një sërë aktiviteteve të reja, si:

- Përgatitja e publikimeve tremujore të analizës së treguesve demografikë me statistikat e lindjes, vdekjes dhe shtesës natyrore;
- Përgatitja e publikimit “Të huajt dhe azilkërkuesit në Shqipëri” bazuar në të dhënat administrative të azilkërkuesve dhe lejet e qëndrimit të dhëna në vendin tonë;
- Kryerja e Anketës së Arsimit të të Rriturve, 2017 për të furnizuar me statistika të të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Kryerja e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, e cila siguron mbledhjen e informacionit mbi strukturën e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri;
- Kryerja e Anketës Pilot për zbatimin e standardeve të reja të statistikave të punësimit

Produktet statistikore në fushën e bujqësisë dhe mjedisit:

- Prodhimi i treguesve mbi sipërfaqen bujqësore të përdorur;
- Prodhimi i statistikave të bimeve të arave;
- Prodhimi i statistikave të drufrutorëve;
- Prodhimi i statistikave mbi metodat e prodhimit bimor;
- Prodhimi i statistikave të pyjeve dhe kullotave;
- Prodhimi i statistikave të biodiversitetit;
- Prodhimi i të dhënave rreth taksave mjedisore dhe llogaritë rrjedhëse fizike mjedisore;
- Prodhimi i llogarive ekonomike në bujqësi, me bazë tre-mujore, vjetore;
- Prodhimi i statistikave të qumështit dhe nënprodukteve të tij, në ferma;
- Prodhimi i statistikave të qumështit dhe nënprodukteve të tij, në industri;
- Prodhimi i statistikave të peshkimit, sipas kategorive ujore, porteve etj;
- Prodhimi i statistikave mbi llogaritë ekonomike në peshkim dhe akuakulturë, në nivel vendi dhe rajonal;
- Prodhimi i statistikave mbi cilesinë e ajrit sipas qyteteve;
- Prodhimi i statistikave mbi cilësinë e ujit në det dhe lumenj;
- Prodhimi i mishit të therur sipas llojeve nga thertoret.

Gjithashtu, për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj kategorie, janë kryer edhe një sërë vërtetimesh të tjera ose pilot, si:

- Vërtetimi pilot mbi mbetjet industriale sipas aktiviteteve ekonomike;
- Vërtetimi pilot mbi ujin dhe përdorimin e tij, sipas aktiviteteve ekonomike;
- Kryerja e vërtetimit vjetor në bujqësi, për vitet 2016 dhe 2017

c) Vizitë studimore në Agjencinë Statistikore të Kosovës me datë 16 Shkurt 2017, ku një nga pikat e axhendës ka qenë shkëmbimi i eksperiencave të dy instituteve në lidhje me Programin e Statistikave Zyrtare.

AKTIVITETE TË PAREALIZUARA

Nga aktivitetet statistikore të parashikuara në Programe, për vitin 2017, nuk janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

Lista e aktiviteteve të parealizuara dhe shkaqet e mosrealizimit, për vitin 2017

Shkaqet në mosrealizimin e aktiviteteve janë të lidhura kryesisht me pamundësinë e marrjes së të dhënave administrative që disponojnë institucionet e tjera publike. Më konkretisht:

1. Aktiviteti statistikor “Çmimet në Industri dhe ndërtim - Kosto në Ndërtim, Punimet inxhinierike” nuk është realizuar për shkak të mungesës së informacionit cilësor mbi çmimet e ndërtimit të materialeve për rrugë nga njësitë statistikore.
2. Aktiviteti statistikor “Statistikat e Inovacionit-Vlerësim i Treguesve” nuk është publikuar për shkak të cilësisë së dobët të të dhënave të mbledhura dhe ekspertizës jo të plotë.
3. Aktiviteti statistikor “Transporti rrugor i mallrave” nuk është realizuar pasi nuk është kryer transmetimi i të dhënave administrative që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor. Me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet INSTAT dhe kësaj drejtorie, do të bëhet e mundur transmetimi në kohë dhe cilësi i të dhënave të kësaj natyre.
4. Aktiviteti statistikor “Vërtetimi mbi produktet sipas listës PRODCOM” nuk është realizuar për shkak të vështirësive që kanë lindur në zbatimin e metodologjisë dhe vërtetimi u shty për në muajin Shkurt 2018.

5. Publikimi i rezultateve të SILC 2016 (Vala e parë) u shty për në vitin 2018 pasi të kontrollohen me të dhënat e Valë së Dytë (2017) dhe të konsolidohet ecuria e anketës që po kryhet për herë të parë në Shqipëri. Një praktikë e tillë është ndjekur edhe nga vendet e tjera që kanë implementuar për herë të parë SILC si Maqedonia, Mali i Zi etj.

Aktivitete të reja statistikore gjatë vitit 2018

Me qëllim përgjigjen sa më të mirë të kërkesave të përdoruesve si dhe rritjen e cilësisë së produkteve statistikore, për vitin 2018, INSTAT ka ndërmarrë inisiativa të reja në të gjitha fushat e prodhimit statistikor. Ndër më kryesoret veçohen:

Statistikat ekonomike:

1. Publikimi i Llogarisë së Prodhimit dhe Gjenerimit të të Ardhurave, sipas sektorëve institucionalë;
2. Llogaritja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit-Taksa Konstante
3. Vlerësimi eksperimental i Indeksit të Çmimeve të Banesave
4. Prodhimi i treguesit të Shitjeve nga burime administrative
5. Përmirësimi i metodës së mbledhjes së çmimeve duke përdorur tabletat, për produktet ushqimore
6. Prodhimi i statistikave mbi bazën e produkteve të industrisë përpunuese (PRODCOM);
7. Prodhimi i statistikave rajonale të ndërmarrjeve;
8. Prodhimi i statistikave të turizmit (strukturat akomoduese);
9. Publikimi i “Turizmi në Shifra”;
10. Kryerja e anketës pilot “Transporti rrugor i mallrave”, me mbështetjen e IPA MB-2015;
11. Prodhimi i statistikave të çmimeve të prodhimit për shërbimet;
12. Piblikimi i regjistrit të mjeteve të transportit rrugor.

Statistikat sociale:

1. Kryerja e Vrojtimit mbi Përdorimin e Teknologjisë së Komunikimit të Informacionit nga ana e Familjeve dhe Individëve, 2018;
2. Publikimi i Rezultateve të Anketës së Kostos së Punës, 2017;
3. Publikimi i Rezultateve të Anketës së Arsimit të të Rriturve, 2017;
4. Analiza e rezultateve të impaktit të përditësimit të standarteve të reja të punësimit;

5. Publikim i veçantë tremujor për Pagat në Shqipëri;
6. Publikim i dedikuar mbi Statistikat e Krimeve;
7. Publikimi i Rezultateve të Anketës së Turizmit – Pushime dhe Udhëtime, 2017-18 në Shqipëri;
8. Publikim i rezultateve të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, 2016-2017;
- 9.
10. Publikim i Statistikave të Sporteve në Shqipëri;
11. Publikime të veçanta mbi Statistikat e Arsimit në Shqipëri;
12. Publikim i veçantë mbi Treguesit e Shëndetit Publik në Shqipëri;

Statistikat e bujqësisë dhe mjedisit:

1. Vrojtimi vjetor në bujqësi për vitin 2017. Llogaritja e tregueseve për prodhimin bimor, blegtoral dhe treguese të llogarive ekonomike në bujqësi
2. Vjorjtimi vjetor në bujqësi për vitin 2018. Përgatitja e pjesës metodologjike të vërtetimit.
3. Vrojimi vjetor për mbetjet industriale dhe llogaritja e treguesve të mbetjeve industriale sipas përbërjes morfologjike dhe aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes;
4. Vrojtimi vjetor për ujën dhe përdorimin e tij. Llogaritja e treguesve të përdorimit të ujit sipas aktivitetit ekonomik;
5. Vrojtimi pilot për strukturën e shpendëve;
6. Të dhëna të tregëtisë së jashtme (import eksporti i shpendëve).
7. Llogaritja e SO (standard outputit) për bujqësinë dhe për blegtorinë;
8. Vërtetimi Pilot për Sipërfaqen e Mbjellë.
9. Mbledhja e të dhënave administrative për prodhimin bimor në nivel bashkie.
10. Mbledhja e të dhënave administrative mbi pyjet, kullotat dhe biodiversitetin në nivel bashkie.
11. Punë përgatitore për realizimin e vërtetimit të përpunimit të lëndës drusore pranë ndërmarrjeve të përpunimit të drurit.
12. Llogaritja e indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore dhe publikimi i tyre
13. Publikimi i të dhënave rreth Llogarive Rrjedhëse Fizike në Mjedis

14. Mbledhja e të dhënave vjetore mbi të mirat dhe shërbimet në mjedis, bazuar në të dhënat administrative
15. Mbledhja e të dhënave vjetore mbi llogaritë e emetimeve në ajër dhe në ujë, bazuar në të dhënat administrativ
16. Struktura e fabrikave dhe e vend grumbullimit të qumështit sipas volumit.

Strategjia e Cens-it të Popullsisë

INSTAT ka planifikuar të kryejë CENS-in e ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave në 1 tetor 2020. Ky aktivitet do të marrë në konsideratë situatën kombëtare, rekomandimet më të fundit ndërkombëtare, në veçanti rekomandimet dhe standardet e adresuara në vendet evropiane nga Kombet e Bashkuara (UN) dhe Eurostat, përfshirë ato që lidhen me cilësinë e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të tij, INSTAT gjatë vitit 2017 ka filluar të zhvillojë një projekt propozim të Dokumentit të Strategjisë së Cens 2020 që përmban një përshkrim të qasjes, një listë paraprake të aktiviteteve që do të ndërmerren dhe një vlerësim preliminar të buxhetit. Ky dokument ka për qëllim të përmbajë të gjitha elementet relevante të një dokumenti të plotë, i cili mund të zhvillohet më tej në të ardhmen pasi të ketë arritur një konsensus të përgjithshëm mbi një dokument të tillë strategjik ndërmjet INSTAT, qeverisë shqiptare, palëve shqiptare, aktorëve ndërkombëtarë dhe komunitetit të donatorëve. Ky ushtrim planifikimi është veçanërisht i rëndësishëm duke marrë parasysh se regjistrimi shqiptar i vitit 2020 duhet të dizajnohet gjithashtu si bazë për regjistrimet e ardhshme në Shqipëri që do të përdorin të dhënat administrative dhe, potencialisht, të regjistrave statistikore.

Cilësia e të dhënave

Sigurimi i cilësisë garanton respektimin e kërkesave lidhur me proceset statistikore si dhe përlogaritjen e treguesve të cilësisë, në përputhje me programin e statistikave zyrtare. Çdo komponent i cilësisë statistikore është referencë për çdo aktivitet mbi të cilët duhet të bazohet përpilimi i statistikave.

Sigurimi i cilësisë është i rëndësishëm për çdo aktivitet dhe për çdo fazë operacionale të proceseve statistikore. INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e paanshmërisë, cilësisë së proceseve dhe produkteve statistikore, orientimit ndaj përdoruesit, orientimit ndaj punonjësve efektivitetit të proceseve statistikore dhe reduktimit të ngarkesës së të intervistuarve. Në kryerjen e detyrave, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice).

Gjatë vitit 2017, INSTAT përpiloi një sërë dokumentash standarde për menaxhimin e cilësisë, i udhëhequr nga standardet e raportit të cilësisë, bazuar në Sistemin Statistikor Europian. Këto standarde përcaktojnë ESMS (Euro SDMX Metadata Structure): raportin e cilësisë i orientuar për përdoruesit, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të raporteve të përpiluara gjatë vitit të fundit. Raportet me standartin ESMS të publikuara gjatë vitit 2017 janë: Llogaritjet e Popullsisë, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve Ekonomike, Indeksi i Çmimeve të Konsumit, Raporti i Energjisë Elektrike, Tregtia e Jashtme, Lejet e Ndërtimit, Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (Banesa), Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, Indeksi i Çmimeve të Importit, Tregtia me Pakicë, Statistikat Afatshkurtra si dhe raportin e cilësisë mbi rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjeve.

Ndërkohë përsa i përket standardit ESQRS (ESS Standard Quality Report Structure): raport i cilësisë i orientuar për prodhuesit e statistikave, INSTAT gjatë vitit 2017, ka përpiluar raportet e Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve si dhe Anketës së Forcave të Punës.

Në mënyrë që të automatizohet procesi i raportimit të cilësisë, INSTAT në 2017 punoi për zhvillimin e një sistemi i bazuar në SIMS v2. Sistemi bën të mundur:

1. Plotësimin e metadatës sipas standardeve të raportimit të cilësisë në një sistem të unifikuar;
2. Gjenerimin e raporteve në format pdf (për publikim në faqen e internetit)
3. Gjenerimin e raporteve në format xml (për dërgimin e metadatave në EUROSTAT)

Angazhimi për cilësinë

INSTAT synon të ofrojë produkte dhe shërbime statistikore që korrespondojnë me nevojat statistikore të informacionit të grupeve të ndryshme të përdoruesve. Përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor kryhet vazhdimisht duke kërkuar kostot më të ulëta të mundshme dhe duke zvogëluar barrën e përgjigjes. INSTAT, në vitin 2017, ka bërë të disponueshëm për publikun Angazhimin për Cilësinë. Nëpërmjet këtij dokumenti, INSTAT angazhohet për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara.

Në kuadër të hartimit të strategjisë 2018-2030 të INSTAT, një nga nënobjektivat është edhe Auditit Statistikor. Roli i sigurimit të Cilësisë dhe Auditimit përfshin zhvillimin e një sistemi efektiv dhe formal të menaxhimit të cilësisë dhe auditimit dhe ofrimin e mbështetjes në çështjet që lidhen me zbatimin e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane. Përveç kësaj, INSTAT është përgjegjës për prodhimin e një sërë Standardesh dhe Udhëzuesish për cilësinë e aspekteve statistikore dhe jo statistikore. Këto standarde dhe udhëzime do të përbëjnë bazën për auditimet e cilësisë statistikore. Gjatë vitit 2017 ka filluar puna për hartimin e planit për pilotimin e auditit statistikor.

Ngarkesa e të Intervistuarve

Statistikat ekonomike përdorin vetëm një tregues për të vlerësuar ngarkesën e të intervistuesve (Response burden) numrin e pyetësorëve që ndërmarrjet duhet të përgjigjen.

Baza e zgjedhjes për vrojtimit e INSTAT është Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve. Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes për vitin 2017, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimit pranë ndërmarrjeve ekonomike, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes


Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
1_9 të punësuar	135.735	16.467	370	619
10_19 të punësuar	346	2.138	777	305
20_49 të punësuar	407	906	735	320
50+ të punësuar	260	390	292	706

Në vitin 2017, janë anketuar rreth 14,9 % e ndërmarrjeve nga 160.773 të regjistruara në vitin 2016. Janë intervistuar gjithsej 24.025 ndërmarrje, nga të cilat 82,8 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në pesë ose më pak vrojtime, ndërsa 17,2 % e tyre kanë marrë pjesë në më shumë se 5 vrojtime të realizuar nga INSTAT, pranë ndërmarrjeve gjatë vitit 2017.

Në lidhje me “Ngarkesën e të intervistuarve”, për indikatorin Numrin e pyetësorëve që INSTAT i dërgon ndërmarrjeve për t’u përgjigjur nuk mund të krahasohet me vitin e mëparshëm pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Gjatë vitit 2017 INSTAT pranë ndërmarrjeve ka realizuar 9 vrojtime të reja, ndër të cilat 1 prej tyre ka frekuencë mujore.

Tabela 3: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
50+ pun	15,8 %	23,7 %	17,7 %	42,8 %
20_49 pun	17,2 %	38,3 %	31,0 %	13,5 %
10_19 pun	9,7 %	60,0 %	21,8 %	8,6 %
1_9 pun	88,6 %	10,7 %	0,2 %	0,4 %



Në grupin e ndërmarrjeve të vogla (1-9 të punësuar), ku është i përqendruar numri më i madh i ndërmarrjeve të vendit, pjesa më e madhe e tyre rreth 88,6 %, nuk kanë për të plotësuar asnjë pyetësor, 10,7 % kanë për të plotësuar 1 deri në 5 pyetësorë dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre (më pak se 1 %) ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Siç shikohet nga grafiku, në grupin e ndërmarrjeve me 20 deri 49 të punësuar, 86,5 % e tyre ngarkohen deri në maksimumi

10 pyetësorë për t'u përgjigjur dhe vetëm 13,5 % e tyre ngarkohen me mbi 10 pyetësorë. Ngarkesa e përgjigjes është relativisht e lartë në grupin e ndërmarrjeve me 50 të punësuar e lart ku rreth 84,2 % e tyre duhet t'u përgjigjen të paktën 1 pyetësori.

Statistikat pranë familjeve përdorin dy tregues për të vlerësuar "Ngarkesën e të intervistuarve": Numrin e pyetësorëve që INSTAT i dërgon familjeve për t'u përgjigjur dhe kohëzgjatjen e intervistës. Gjatë vitit 2017 INSTAT ka realizuar 9 anketa pranë familjeve. Në lidhje me "Ngarkesën e të intervistuarve", për indikatorin Numrin e pyetësorëve që INSTAT i dërgon familjeve për t'u përgjigjur nuk mund të krahasohet me vitin e mëparshëm pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Gjatë vitit 2017 INSTAT pranë familjeve ka realizuar 3 vrojtime të reja, ndër të cilat 1 prej tyre ka frekuencë tremujore.

Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristika të familjeve dhe individëve, që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrativë. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e ngarkesës janë fokusuar në lehtësitë që mund t'i krijohen familjeve, përsa i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit, që mund të jetë i disponueshëm.


Të gjitha anketat pranë familjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2017 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes rezultatet e Censusit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Në vitin 2017 janë anketuar rreth 6,5% Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722.262 të regjistruara në Census. Janë intervistuar gjithsej 46.940 NJEF, nga të cilat 72,5% e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vërtetim, ndërsa 27,5 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vërtetime të realizuar nga INSTAT, pranë familjeve gjatë vitit 2017. Shpërndarja e numrit të vërtetimeve sipas qarqeve për vitin 2017, duke marrë në konsideratë të gjitha vërtimet pranë familjeve që realizon INSTAT, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4: Shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve

Qarku	Asnjë vërtetim	Një vërtetim	Dy e më shumë vërtetime	Numri i NjEF për Qark
Berat	35.991	1.795	707	38.493
Dibër	27.554	1.435	584	29.573
Durrës	62.191	3.225	1.235	66.651
Elbasan	68.194	3.500	1.350	73.044
Fier	76.781	3.852	1.468	82.101
Gjirokastrë	19.600	1.167	494	21.261
Korçë	56.151	2.897	1.123	60.171
Kukës	15.791	935	400	17.126
Lezhë	29.975	1.576	686	32.237
Shkodër	50.757	2.551	1.119	54.427
Tiranë	184.717	8.742	2.758	196.217
Vlorë	47.620	2.368	973	50.961
Gjithsej	675.322	34.043	12.897	722.262


Gjatë vitit 2017, në qarkun e Tiranës janë intervistuar gjithsej 11.500 NJEF ose 5,9 % e tyre. Rreth 94,1 % e familjeve të qarkut Tiranë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë vërtetim, 4,5 % e tyre kanë marrë pjesë në 1 vërtetim dhe vetëm 1,4 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vërtetime të realizuara nga INSTAT.

Figura 1: Ngarkesa e përgjigjes për NJEF që janë përzgjedhur për t'u intervistuar gjatë vitit 2017



Kohëzgjatja mesatare e intervistës për disa nga anketat pranë familjeve në vitin 2017 jepet në figurën e mëposhtme.

Figura 2: Kohëzgjatja e intervistës mesatare/ NJEF



Kohëzgjatja e intervistës mesatare për familje, për Anketën e Forcave të Punës është rreth 21 minuta, për Anketën e Besimit të Konsumatorit është rreth 21 minuta, për Anketën e Borxhit Pranë Familjeve është rreth 25 minuta, për Anketën e Arsimit të të Rriturve është rreth 30 minuta, për Anketën e Turizmit "Pushime Dhe Udhëtime" në Familje është rreth 38 minuta, për Anketën e Buxhetit të Familjes është rreth 43 minuta dhe për Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës kohëzgjatja mesatare e intervistës është rreth 76 minuta.

Në lidhje me Kohëzgjatjen e intervistës mesatare për familje, për Anketën e Forcave të Punës dhe Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës kohëzgjatja mesatare e intervistës është e njëjtë me vitin e mëparshëm, ndërsa për Anketën e Buxhetit të Familjes kohëzgjatja është përmirësuar me 1 minutë.

Auditimi i Teknologjisë së Informacionit

Gjatë 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) zhvilloi një Auditim me fokus auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit. Auditimi u fokusua në vlerësimet e mëposhtme:

- Menaxhimin, vlerësimin dhe monitorimin e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit, me qëllim përmbushjen e misionit;
- Stafi i drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe burimet në dispozicion;
- Strategjitë e politikat mbi vazhdimësinë e punës;
- Siguria e informacionit;
- Integriteti, disponueshmëria dhe konfidencialiteti i informacionit.

Rekomandimet e lëna nga ky auditim do të zbatohen gjatë 2018 e në vijimësi.

Indikatorët e PAF

Një nga objektivat e INSTAT është ndërtimi i kornizës për vlerësimin e performancës institucionale, e cila ka për qëllim të kontribuojë në rritjen e njohurive dhe mirëkuptimin e rrugëve me anë të të cilave INSTAT punon në plotësimin e kërkesave si agjenci statistikore në menaxhim, kontroll dhe ndjekje.

Gjatë vitit 2017 INSTAT ka punuar për identifikimin e indikatorëve, të cilët do të shërbejnë për matjen dhe vlerësimin e performancës së institucionit, ndërtimin e kalendarit rrotullues të aktiviteteve menaxhuese sipas muajve (PAF wheel), si dhe ka hartuar planin për udhëzuesin e vlerësimit të performancës institucionale.

Tabela me Indikatorët PAF

Nr	Indikatorët	Përshkrimi	2016	2017	Synimi 2018
1	Numri i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM	Numri i aktiviteteve statistikore të dokumentuara sipas Modelit të Përgjithshëm të Dokumentimit të Proceseve Statistikore (GSBPM)		0	49
2	Numri i publikimeve të reja	Numri i publikimeve të reja të shtrira gjatë një viti kalendarik, sipas Kalendarit të Publikimeve		41	48 (ose rritje me 17%)
3	Numri i publikimeve në kohë	Numri i publikimeve jashtë kohës së parashikuar në Kalendarin e Publikimeve.		5	0
4	Numri i aktiviteteve që kanë përmirësim afati	Numri i aktiviteteve të kryera përpara afatit gjatë një viti kalendarik.		4	27
5	Indikatorët në botimet e vogla Evropiane	Numri i indikatorëve nga Shqipëria në botimin e Eurostat (indikatorët kryesorë në vendet në zhvillim)		77%	85%
6	Produkte statistikore bazuar në burime administrative, plotësisht dhe pjesërisht	Numri i produkteve statistikore të cilat bazohen plotësisht dhe pjesërisht mbi të dhënat administrative		24	28
7	Numri i aktiviteteve statistikore që kryhen në përputhje me standartet e EU	Vlerësimi i numrit të aktiviteteve statistikore që kryhen në përputhje me standartet ndërkombëtare.		I Ulët-13	I Ulët-31
				I Mesëm- 13	I Mesëm- 20
				I Lartë- 1	I Lartë- 3
				Jo të përputhshëm-38	Jo të përputhshëm-11
8	Numri i vizitave në web site të INSTAT	Vlerësimi i numrit të shikuesve të faqes së Web-INSTAT		1.300.061	Rritje me 20%

Anketa e kënaqësisë së përdoruesve të INSTAT

Rezultatet e përmbledhura

Përdoruesit e të dhënave të INSTAT ishin më shumë femra (53,1 %). Pjesa më e madhe e përdoruesve (49,2 %) i përkisnin grupmoshës nga 21-30 vjeç. Mosha mesatare e përdoruesve është 33 vjeç. Rreth 92,8 % e përdoruesve kishin një diplomë universitare, 26,8 % e përdoruesve ishin student dhe grupi i dytë më i madh i përdoruesve ishin kërkues shkencor (23,4 %).

Nga numri i përgjithshëm i përdoruesve të anketuar, 55,1 % kanë mbledhur të dhëna nëpërmjet faqes së internetit të INSTAT, rreth 55,9 % e përdoruesve kanë mbledhur të dhëna për arsye kërkimore dhe 27,1% për informacion të përgjithshëm. Rreth 24,8 % e përdoruesve përdorën të dhënat çdo muaj dhe të dhënat më të kërkuara ishin nga fusha e Popullsisë (29,5 %), Niveli i Jetesës (25,2 %) dhe Çmimet (24,8 %).

Duke parë cilësinë e përgjithshme të të dhënave (afatet kohore, disponueshmërinë dhe krahasueshmërinë e tyre) përdoruesit dhanë vlerësimin më të lartë në fushën e Popullsisë (3,62), i ndjekur nga të dhënat mbi Tregtinë e Jashtme (3,49) dhe të dhënat në fushën e Llogarive Kombëtare (3,42).

Vlerësimi kryhet në një shkallë nga 1 tek 5:

- 1=Shumë Dobët,
- 2=Dobët,
- 3=E përshtatshme,
- 4=Mirë,
- 5=Shumë mirë.

Rreth 48 % e përdoruesve mendonin se të dhënat e INSTAT janë të një kualiteti të lartë dhe 68,1% e përdoruesve vlerësoi krahasueshmërinë e të dhënave të INSTAT si të mira. Një pjesë e përdoruesve (38,3 %) besonin se të dhënat e INSTAT nuk i plotësojnë nevojat e tyre për

statistika dhe 21,9 % e përdoruesve nuk ishin të kënaqur me mënyrën se si ato mund të aksesonin të dhënat e INSTAT.

Përdoruesit ishin më pak të kënaqur me ndërtimin e faqes së internetit dhe i dhanë një vlerësim mesatar prej 2,78. Përdoruesit i dhanë përmbajtjes së faqes së internetit një vlerësim mesatar prej 3,42. Kalendari i Publikimeve statistikore është përdorur nga 56,2 % e përdoruesve.

Përdoruesit vlerësuan ndihmën e punonjësve me 3,54 dhe profesionalizmi i punonjësve u vlerësua me 3,51. Shpejtësia e marrjes së informacioneve u vlerësua me 3,41 dhe thjeshtësia e kontaktimit me punonjësit me 3,35.

Përdoruesit ishin të kënaqur me shpejtësinë e marrjes së përgjigjeve (38, 9% e përdoruesve). Rreth 39,4 % e përdoruesve ishin të kënaqur me kualitetin e përgjigjeve ndërsa 47,0 % e përdoruesve mendonin se komunikimi me punonjësit ishte i kënaqshëm. Rreth 25,4 % e përdoruesve nuk ishin të kënaqur me numrin e statistikave.

Cilësia e përgjithshme e të dhënave dhe shërbimeve të INSTAT-it ishte e mirë, siç raportohet nga 38,7 % e përdoruesve, 34,8 % e tyre mendonin se kualiteti ishte i përshtatshëm dhe 15,2 % e konsideruan atë të shkëlqyer. Rreth 9,2 % e përdoruesve mendonin se cilësia e të dhënave dhe shërbimet ishin të varfëra, 2,1 % e konsideruan shumë të keqe.

Rreth 40,8 % e përdoruesve ndoqën INSTAT në Facebook.

Integrimi Evropian dhe Koordinimi i Projekteve

Gjatë vitit 2017, janë kryer një sërë aktivitete të parashikuara por edhe të tjera që kanë lindur sipas nevojave të veprimtarisë së Institucionit, në zbatim të objektivave dhe planit të punës. Ka mbajtur komunikime të vazhdueshme me Eurostat dhe organizatat e tjera si UN, UNECE, OECD, EFTA dhe Institutet Statistikore kombëtare të huaja mbi aktivitetet ndërkombëtare, si dhe ka ndjekur zbatimin e projekteve që Institucioni është përfitues.

Aktivitetet e vazhdueshme të realizuara për vitin 2017

Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

- Përditësimin e raportimit të zbatimit të rekomandimeve të nënkomitetin ECOFIN 2017.
- Përgatitjet dhe dërgimi i kontributit për Progres Raportin e vitit 2017 të Komisionit Evropian për Shqipërinë.
- Organizimi i takimeve mujore të Grupeve Ndërshtetërore të Punës për kapitullin 18, ku INSTAT është lider .
- Koordinimi me Drejtoritë Teknike dhe Ministrinë e Integrimit Evropian mbi zhvillimin e takimit të nëntë të Nënkomitetit Çështjet Ekonomike dhe Financiare dhe Statistikat me datë 28 Shtator në Bruksel ku INSTAT raportoi mbi progresin e statistikave si dhe Komitetin e Stabilizim Asociimit i mbajtur me datë 4 Tetor në Bruksel.
- Përditësimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2018-2020 në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze duke koordinuar me Drejtoritë Teknike dhe me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave për mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit.

Koordinimi me donatorët

- U zhvillua takimi “Koordinimi me Donatorët”, nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, Znj. Ibrahimaj ku u diskutua për objektivat strategjike të INSTAT si dhe prezantimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017 - 2021. Gjithashtu u paraqitën projektet që INSTAT ka në zbatim si dhe nevoja për mbështetje për aktivitetet e ardhshme.

- U organizua takimi “Koordinimi me Donatorët” në Shqipëri nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, Znj. Ibrahimaj. Në këtë takim u prezantua një pasqyrë e detajuar e Censuseve të zhvilluara nga INSTAT dhe përvojën e përftuar, si edhe planet për Censuset e ardhshme shoqëruar me një buxhet paraprak për çdo aktivitet.
- U organizua takimi “Koordinimi me Donatorët” në të cilën INSTAT prezantoi planet për Censusin e ardhshëm i Popullsisë dhe Banesave, Draft Projekt-Dokumentin e Censurit si dhe Draft buxhetin. Këto takime janë pasuar edhe nga takime të tejra bilaterale mes INSTAT dhe donatorëve.
- U zhvillua takimi i radhës i UN - INSTAT Joint Data Group, drejtuar nga Znj. Ibrahimaj dhe bashkëdrejtuese e takimit, Znj. Manuela Bello. Në këtë takim marrin pjesë agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri si dhe përfaqësues të INSTAT Drejtore e Përgjithshme, Znj. Ibrahimaj dhe Znj. Simoni, Përgjegjëse në sektorin e Integrimit Evropian. Takimi i radhës pritet të mbahet në muajin Shkurt 2018.

Takime Ndërkombëtare dhe Konferenca

- U organizua Sesioni i 48-të i Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara, ku mori pjesë Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, Znj. Delina Ibrahimaj e cila mbajti fjalën në mbështetje të projekt-rezolutës për punën e Komisionit Statistikor të OKB-së, në lidhje me Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.
- Gjatë zhvillimit të Konferencës së Statisticienëve Europianë, zhvilluar në Gjenevë, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit i Statistikave (INSTAT) dhe Drejtori i Zyrës së Statistikave të Republikës së Serbisë (SORS) nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për statistikën zyrtare. Memorandumi krijon një kornizë dhe kushte të përgjithshme për bashkëpunimin efikas. Qëllimi i këtij MoU është bashkëpunimi në fushat statistikore të ndryshme, veçanërisht në çështjet e TIK-së, çështjet metodologjike dhe cilësore, si dhe çështjet infrastrukturore dhe organizative.
- Departamenti i Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri, Zyra e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe Delegacioni Evropian organizuan forumin “Shqipëria në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE dhe SDG ” ku Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, Znj. Ibrahimaj përveç fjalës së rastit, drejtoi edhe një nga sesionet e këtij forumi. Sektori i Integrimit Evropian përgatiti materialet dhe prezantimin për këtë aktivitet.

- INSTAT u përfaqësua në Kongresin e 61-të Statistikor Botëror - ISI në Marrakesh. Konferenca e Institutit Ndërkombëtar të Statistikave (ISI) dhe shtatë shoqata të saj mbledhën sëbashku statisticienë të shquar dhe anëtarë të komunitetit statistikor nga pesë kontinentet për të prezantuar, diskutuar, dhe të shpërndajnë hulumtime dhe promovimin e praktikave më të mira në çdo fushë të statistikave dhe aplikimeve të saj. ISI 2017 shfaqti një program të pasur shkencor duke u fokusuar në njohuritë e fundit dhe inovacionit në statistika.
- U organizua Konferenca DGINS 2017, e cila mbahet një herë në vit me qëllim diskutimin e temave që lidhen me programin statistikor, metodat dhe proceset për prodhimin e statistikave. DGINS 2017 kishte në fokus temën "Lëvizjet e Popullsisë dhe Çështjet e Integrimit - Statistikat e Migracionit" si dhe një seancë të brendshme mbi "Strategjinë e ESR-së përtej 2020". Gjatë konferencës u organizuan edhe takime bilaterale me Drejtuesit e Statistikave të Greqisë, Italisë dhe Eurostat në lidhje mbi mundësitë e shkëmbimit të të dhënave të migracionit.
- Universiteti Epoka së bashku me Institutin e Statistikave dhe Shoqërisë Ekonomike të Shqipërisë organizuan Konferencën Ndërkombëtare për Statistikat e Aplikuara dhe Ekonometrinë me pjesëmarrje mbi 200 akademikë nga e gjithë bota. Folësit kryesorë të konferencës ishin Prof. Dr. Donald B. Rubin Departamenti i statistikave, Universiteti i Harvardit, Prof. Dr. Soren Johansen Departamenti i Ekonomisë, Universiteti i Kopenhagen dhe Prof. Dr. Duo Qin Departamenti i Ekonomisë, SOAS, dhe Universiteti i Londrës dhe Znj. Delina Ibrahimaj Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT. Qëllimi i kësaj konference ishte që Akademikët, shkencëtarët, kërkuesit dhe studiuesit kërkimorë të ndanin përvojat dhe rezultatet e kërkimeve të tyre në lidhje me Statistikat e Aplikuara dhe Ekonometrinë. Gjithashtu sigurimin e forumeve të veçanta për studiuesit, praktikantët dhe akademikët për të paraqitur dhe diskutuar të rejtat më të fundit si dhe sfidat praktike të hasura dhe zgjidhjet e miratuara në fushën e Statistikave të Zbatuara dhe Ekonometrinë.
- U organizua event i "Të transformojmë statistikën në njohuri dhe vendim-marrje" me mbështetjen e projektit të Bashkëpunimit Suedeze me pjesëmarrjen dhe kontributin e botës akademike, përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrive, Bankës së Shqipërisë pjesëmarrjen dhe kontributin e Drejtoreshës së Statistikave të Malit të Zi si dhe Ambasadës Suedeze në Tiranë. Përfaqësuesit prezantuan dhe ndanë ekperiencat e tyre mbi rolin e statistikave në

vendimmarrje, në analiza dhe parashikime si dhe roli i tyre mbi matjen e strategjive të ndryshme kombëtare.

- INSTAT organizoi konferencën për treguesit gjinorë “Burrat dhe Gratë në Shqipëri”, publikim që përmban një informacion më të plotë mbi statistikën gjinore në vendin tonë si dhe disa risi lidhur me to i cili është mbështetur nga Entitetin e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women). Në këtë event u diskutua rëndësia e këtij publikimi dhe si mund të pasurohet ky publikim në të ardhmen
- INSTAT organizoi dhe priti takimin e përvitshëm të Eurostat PGSC, Grupi i Politikave të Bashkëpunimit Statistikor ku morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Marrëdhënieve me Jashtë të Eurostat Z. Pieter Everaers dhe Desk officer për Shqipërinë Z. Torbjörn Carlquist dhe kolegë të tjerë të njësisë së Marrëdhënieve me Jashtë në Eurostat. Gjithashtu në këtë takim morën pjesë drejtuesit e institucioneve statistikore në rajon sëbashku me përgjegjësit e marrëdhënieve me jashtë, donatorë dhe organizata ndërkombëtare si EFTA dhe DG NEAR dhe Delegacionin Evropian.
- U organizua Dita Evropiane e Statistikave, INSTAT në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe Ministrinë e Financave organizuan një aktivitet publik me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin në përdorimin e statistikave. Gjatë këtij aktiviteti u përdorën mjete vizive për të promovuar statistikën si një e mirë publike. Sektori i Integrimit Evropian asistoi në organizimin e këtij event.
- Në kuadër të bashkëpunimit të INSTAT dhe SESRIC (Qendra e Trajnimeve dhe Kërkimeve Statistike, Ekonomike dhe Sociale për vendet Islamike), INSTAT dhe STATCAB organizuan në ambientet e INSTAT kursin e trajnimit mbi “Sistemin e Informacionit Gjeografik, GIS” i cili ishte shumë i vlefshëm duke marrë në konsideratë faktin se censusi i ardhshëm i popullsisë dhe banesave në Shqipëri do të kryhet nëpërmjet përdorimit të tableteve.

Projektet me financime të ndryshme, të zbatuara në INSTAT gjatë vitit 2017 janë si më poshtë.

1. Programi kombëtar IPA 2013

INSTAT është institucion përfitues i asistencës së Bashkimit Evropian në kuadër të IPA 2013 me projektin me titull “Mbështetje për Përmirësimin e Sistemit të Informacionit Statistikor”. Projekti ka si qëllim kryesor të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes dhe përgjegjshmërisë nëpërmjet politikave socio-ekonomike, me një qasje më të mirë në statistika cilësore të përafruara me legjislacionin Evropian. Autoriteti kontraktues është Drejtoria e Përgjithshme e Financimit dhe Kontraktimit (CFCU) pranë Ministrisë së Financave të Shqipërisë. Për arritjen e qëllimit kryesor, projekti ndahet në 3 komponentët:

Komponenti 1 – Ristrukturimi dhe përmirësimi i proceseve të statistikave të biznesit dhe rritja e kapaciteteve në prodhimin dhe përdorimin e statistikave bujqësore dhe të fuqisë punëtore.

Komponenti 2 – Zhvillimi dhe testimi i sistemit të infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nëpërmjet ndërtimit të sistemit qendror Data Warehouse.

Komponenti 3 – Përmirësimi i funksioneve komunikuese dhe rolit koordinues të INSTAT me fokus në shpërndarjen dhe menaxhimin e cilësisë së informacionit.

Zbatimi i projektit ka filluar në 06.06.2016 dhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar puna për kryerjen e aktiviteteve për të tre Komponentët.

Tabela 7: Realizueshmëria e aktiviteteve në % është si më poshtë:

Komponenti	Aktivite të planifikuara	Aktivite të realizuara	Realizueshmëria në përqindje
Komponenti 1	23	14	61%
Nën- komponenti 1 a	8	6	75 %
Nën- komponenti 1 b	5	2	40 %
Nën- komponenti 1 c	10	6	60 %
Komponenti 2	6	3	50 %
Komponenti 3	11	3	27 %

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar 3 Mbledhje të Komitetit Drejtues një prej të cilave Ad-Hoc, me qëllim diskutimin mbi problematikat e hasura gjatë periudhës së zbatimit si dhe ecurinë e projektit.

Gjithashtu si mjet për të monitoruar zbatimin e projektit kanë qenë edhe takimet javore të njësisë së ZLP/SPO me Kontraktorin si dhe takimet mujore ndërmjet njësisë së ZLP/SPO, stafit të INSTAT dhe Kontraktorit, për të diskutuar ecurinë e projektit.

2. Partneriteti për statistikën Faza e 4-të, Sida

Gjatë vitit 2017, ka qenë në zbatim faza e katërt e bashkëpunimit midis SCB dhe INSTAT, duke siguruar kështu një ndihmë të konsiderueshme në përmirësimin e metodologjisë statistikore, krijimin e infrastrukturës teknologjike të sistemit të përpunimit të informacionit statistikor, ofrimit të ekspertizës pranë INSTAT për fusha të ndryshme statistikore si Menaxhim, Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit, Statistikat Ekonomike dhe Biznesit, Metodologjia Statistike, Statistikat Sociale, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit etj. Kjo fazë e asistencës përfshin periudhën prej Tetorit të vitit 2014 deri në Dhjetor të 2017.

Gjatë vitit 2017, Sektori i Koordinimit të Projekteve ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me zyrën e SCB në INSTAT, konsulentin e tyre të përhershëm për të kontribuar në lehtësimin e komunikimit me sektorët e INSTAT, mbështetje organizative dhe logjistike për realizimin e aktiviteteve të projektit, si takime të Komitetit Drejtues si dhe mbledhjet mujore me përfaqësues të grupit të punës.

3. Financim i drejtpërdrejtë në INSTAT për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e një qendre trajnimi

Gjithashtu, INSTAT ka përfituar nga Sida edhe një projekt me përgjegjësi të plotë të menaxhimit të fondeve nga vetë INSTAT që ka mbuluar financiarisht prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e një qendre trajnimi. Objektivi kryesor është modernizimi i platformës ekzistuese të infrastrukturës dhe krijimi i një qendre trajnimi.

Sektori i Koordinimit të Projekteve ka kontribuar në mbajtjen dhe zbardhjen e minutave për Mbledhjen e Komitetit Drejtues.

4. Rritja e Kapaciteteve të Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, SMEI.

Ky projekt vjen në kuadër të Programit Ballkan Mediterranean 2014-2020" i cili ka për qëllim promovimin e forcimit të bashkëpunimit në rajon. Ky Program synon ndarjen e eksperiencës, përmirësimin e politikave publike dhe lidhjen e tyre ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale

dhe lokale si dhe aktorë të tjerë të rajonit Ballkano - Mesdhetarë. Programi sjell së bashku 5 vende, prej të cilave 3 vende anëtare të BE-së (Bullgari, Greqi, Qipro) dhe 2 vende kandidatë (Shqipëri, Maqedoni).

Objekti kryesor i këtij projekti është të rrisë kapacitetin ndërkombëtar të Ndërmarrjeve të

Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe ti mbështesë ato në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm, duke përfshirë grupe inovative me NVM të tjera nga rajoni për të ndarë njohuritë dhe zhvillimin e inovacioneve.

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- a) Reduktimi i hendekut në rajon mbi inovacionin e NVM-ve (SME).
- b) Forcimi i konkurrueshmërisë së NVM-ve përmes njohjes dhe të kuptuarit e kapaciteteve aktuale të inovacionit dhe forcimi i kapaciteteve të NVM-ve duke siguruar mjetet dhe strategjitë e nevojshme për të arritur qëllimin.
- c) Përmirësimi i kapaciteteve ndërkombëtare të inovacionit.
- d) Rritja e njohurive të NVM-ve mbi kapacitetet e tyre inovative.
- e) Ndarja e njohurive duke sugjeruar formacionet e grupeve ndërkombëtare.
- f) Mbështetja e politikbërësve në vendimmarrje bazuar në fakte në fushën e inovacioneve duke siguruar të dhëna statistikore për krahasueshmërinë në nivelin ndërkombëtar, kombëtar dhe sektorial të NVM-ve.

Më datë 20 Korrik është nënshkruar Marrëveshja e Partneritetit dhe në datë 1 Gusht ka filluar periudha e zbatimit të projektit. Në datën 3 Tetor 2017 në Sofje, Bullgari u organizua Takimi i parë (Kick off Meeting) me qëllim prezantimin e partnerëve të projektit, diskutimin mbi planin e aktiviteteve që do të kryen në kuadër të projektit, rezultatet e pritshme si dhe mënyrën e menaxhimit të tij.

Në datë 10 Tetor është organizuar dita e informimit (Info Day) e cila kishte për qëllim të informonte partnerët e projektit mbi të gjitha procedurat që do të ndiqen dhe dokumentacionin që duhet të plotësohet. Sektori i Koordinimit të Projekteve ka përgatitur dhe dërguar dokumentat lidhur me planin e prokurimeve, planin e punës, aplikimin për kodin e Sistemit të

Menaxhimit të Informacionit (MIS) si dhe të gjitha dokumentacionet e kërkuara nga Partneri Kryesor.

5. Projekti SALSTAT

•Në datat 19-21 Prill, INSTAT priti misionin e parë në kuadër të Projektit “Strong Albanian Local Statistics” financuar nga SDC, “Bashki të forta” - SALSAT nga Zvicra në kuadër të një projekti që INSTAT do të ketë me mbështetjen e Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Projekti do të menaxhohet nga INSTAT dhe Zyra Statistikore e Zvicrës dhe misioni i parë ka për qëllim vlerësimin e situatës aktuale mbi të dhënat në nivel lokal, i cili do ndihmojë në përgatitjen e draft raportit mbi fokusin dhe rezultatet që priten nga ky projekt. Projekti do ketë një fazë inception për një vit, do të ketë një kohëzgjatje prej 4 vitesh me një mundësi shtyrje dhe për 4 vite të tjera. Gjatë misionit u ka patur takime të ndryshme me përfaqësues të ministrive, Bashkisë së Tiranës, Shijakut dhe Vlorës.

•Gjatë vitit 2017 ka filluar zbatimi i fazës fillestare të Projektit SALSTAT ku misioni i parë është organizuar në muajin Prill, dhe Sektori i Integrimit Evropian ka ndjekur dhe organizuar takime dhe vizita të ndryshme brenda dhe jashtë institucionit. Në datat 30 Gusht - 13 Shtator 2017, u organizua një tjetër mision për të diskutuar mbi qëllimin e projektit dhe mundësitë e bashkëpunimit me donatorë të tjerë që kanë si fokus ngritjen e kapaciteteve te nivelit lokal.

6. Programi i Bashkëpunimit Statistikor Shumë-Përfitues IPA

Programi i Bashkëpunimit Statistikor Shumë-Përfitues IPA 2015 me financim të Bashkimit Evropian ku periudha e zbatimit është nga data 1 Prill 2017 - 31 Tetor 2019. Vendet përfituese të këtij programi janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Kosova dhe Turqia.

Objekti i përgjithshëm i programit është përgatitja e autoriteteve statistikore në vendet përfituese për anëtarësim në BE duke përshtatur metodologjitë dhe praktikat e tyre me acquis dhe duke i integruar ato në Sistemin Evropian të Statistikave. Në kuadër të objektivit të përgjithshëm, qëllimet specifike të programit janë: (i) përmirësimi i disponueshmërisë dhe cilësisë së të dhënave statistikore në vendet përfituese e cila është thelbësore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave evropiane dhe për përgatitjen e përfituesve për anëtarësimin e ardhshëm në BE; (ii) për të përmirësuar dhe përforcuar sistemet statistikore në vendet përfituese, duke

përmirësuar disponueshmërinë, cilësinë, krahasueshmërinë dhe afatet kohore të të dhënave statistikore në veçanti në fushat kryesore si vijon: statistikatat makroekonomike, statistikatat e bujqësisë, statistikatat sociale, statistika e ndërmarrjeve etj.


Programi IPA Shumë-përfitues siguron mbështetje dhe asistencë në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ekspertizës institucionale përmes pjesëmarrjes në kurset e trajnimeve dhe trajnimet afatgjata për periudhën 3 - 5 mujore në Institucionet Kombëtare të vendeve anëtare dhe në Eurostat, pjesë marrja në takimet dhe grupet punës të Sistemit Statistikor Evropian.

Një nga mbështetjet më të rëndësishme të programeve IPA MB 2014 dhe IPA MB 2015 janë që të sigurojnë asistencë teknike specifike dhe ekspertizë për projektet pilote të ndryshme me qëllim përmirësimin e grumbullimit, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave cilësore.


1) Në kuadër të programit shumë-përfitues të bashkëpunimit statistikor IPA 2014 dhe IPA 2015 janë realizuar :

- a) Aktivitetet horizontale të organizuara në kuadër të IPA 2014 (82 takime, 9 workshope, 47 kurse trajnimi, 8 vizita studimore, 3 trajnime afatgjata dhe 7 aktivitete të tjera).

Figura 7: Aktivitetet në kuadër të IPA



- a) Aktivitetet horizontale të organizuara në kuadër të IPA 2015 (22 takime, 5 workshope, 11 kurse trajnimi, 8 trajnime afatgjata dhe 1 aktivitet tjetër).

Figura 8: Aktivitetet në kuadër të IPA 2015

- 1) Në kuadër të programit shumë-përfitues të bashkëpunimit statistikor IPA 2014 janë finalizuar 20 projektet pilote ku deri tani 15 prej tyre janë aprovuar nga EUROSTAT.

Monitorimi i pyetësorëve

- Monitorimi i plotësimit dhe dërgimit në afat të 31 pyetësorëve të ardhur nga institucione statistikore dhe organizata ndërkombëtare të huaja si: Eurostat, UNICEF, UNESCO, UNESCO-UIS, UNECE, OBT, CEFTA, The International Road Federation, FAO, etj.
- Përditësimi i databazës së këtyre pyetësorëve.

Plani aktiviteteve për vitin 2018

- Ndjekja e detyrimeve të Institucionit në zbatim të axhendës së Integrimit Evropian.
- Komunikimet me Eurostat dhe Institucionet e tjera ndërkombëtare
- Asistencë ndaj Drejtorive teknike mbi pjesëmarrjen e stafit në aktivitete brenda dhe jashtë vendit si dhe koordinimi i misioneve të huaja që vijnë në INSTAT.
- Asistencë dhe koordinim me projektin SALSAT, organizimi i takimeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si dhe përgatitja e dokumentave të nevojshme për fillimin e projektit.

- Koordinim, informim dhe përgatitje të materialeve të ndryshme në zbatim të axhendës 2030 mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Përgatitja dhe asistencë për takime, forume kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të OZHQ-ve.
- Asistencë ndaj Drejtorit të Përgjithshëm me materiale mbështetëse për aktivitete dhe takime të caktuara si dhe koordinimi i vizitave ndërkombëtare.
- Komunikimet me Eurostat dhe Institucionet e tjera ndërkombëtare
- Zbatimin e Projektit IPA 2013- gjatë vitit 2018 ky projekt do të jetë në fazën e tij përfundimtare (sipas kontratës përfundon në 5 Qershor 2018). Sektori do të përgatisë raportime periodike për të ndjekur ecurinë e projektit, si dhe të gjitha detyrimet që lindin në kuadër të kontratës dhe Manualit të Procedurave të ZLP/SPO-së.
- Gjatë vitit 2018 do të kryhen procedurat e prokurimit për blerjen e tabletave, procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e kompanisë e cila do të kryejë punën në terren si dhe kryerja e anketës e cila është parashikuar të kryehet në Dhjetor të vitit 2018.
- Zbatimin e Projektit SIDA Faza V (Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale në Statistika) - ndjekja administrative, koordinimi dhe raportime për zbatimin e projektit. Koordinimi i takimeve me grupin e punës për të ndjekur ecurinë e projektit, organizimi i Mbledhjeve të Komitetit Drejtues, etj.
- Zbatimin e Projektit SALSTAT (Statistika të Forta Vendore Shqiptare)- koordinimi/ndjekja administrative/raportime për zbatimin e projektit
- Zbatimin e Projektit të financuar nga Banka Botërore (Krijimi i një Strategjie Kombëtare për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor)- ndjekja administrative/raportime për zbatimin e projektit. Qëllimi i grantit është të mbështesë INSTAT-in në përgatitjen një strategjie të re kombëtare për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor për vitet 2018-2033, zhvillimi i planit afatmesëm të veprimit dhe ngritja e kapaciteteve të stafit të INSTAT-it për zbatimin e strategjisë. Është parashikuar që zbatimi i projektit të fillojë në fund të muajit Mars.
- Aplikime për projekte të reja sipas nevojave të institucionit bazuar në Programin e Statistikave Zyrtare.
- Përgatitja e raporteve 4-mujore mbi zbatimin e PSZ-së dhe prezantimi në Këshillin e Statistikave.

- Takime pune/konsultime lidhur me strukturën e re të PSZ-së, me periodicitet 4-mujor.
- Tryeza të rrumbullakta me të gjithë aktorët e përfshirë në prodhimin e Statistikave Zyrtare lidhur me strukturën e re të PSZ-së, me periodicitet 6-mujor.
- Zbatimi i programit shumë-përfitues IPA 2015.
- Zbatimi i aktiviteteve horizontale në kuadër të programit shumë-përfitues IPA 2015, me periodicitet mujor.
- Monitorimi i të gjithë pyetësorëve për vitin 2018, me periodicitet mujor.
- Ndërtimi i aplikacionit online për monitorimin e PSZ-së .
- Strukturimi i organigrames

Publikimet 2017

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve Ekonomike, 2015

Tregtia e Jashtme, 2012 – 2016

Tregu i Punës, 2016

Regjistri i Ndërmarrjeve, 2016

Burra dhe Gratë në Shqipëri, 2017

Tregtia e jashtme sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, 2012-2016

Shqipëria në Shifra, 2016

Vjetari Statistikor Rajonal, 2012- 2016

Vjetari Statistikor 2017


Bizneset e Huaja në Shqipëri, 2014-2016



Kërkesat e përdoruesve

Databaza e përdoruesve u krijua për herë të parë në vitin 2009. Mbi bazën e kësaj databaze INSTAT përcakton dhe njihet më mirë me kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistika. Nëse i referohemi historikut të kësaj databaze, mund të themi që kërkesat e përdoruesve kanë pësuar një rritje të ndjeshme në vitet 2014 dhe 2015, ndërsa në vitin 2016 pati një rënie të numrit të kërkesave nga përdoruesit nga 729 (2015) në 509 (2016). Gjatë vitit 2017 vihet re një rritje e numrit të kërkesave nga përdoruesit në 776 kërkesa nga 509 kërkesa që ka patur në vitin 2016 (267 kërkesa më shumë).


Figura 9: Numri i kërkesave të përdoruesve 2012-2017



Duke e thelluar analizën e statistikave të plotësimit të kërkesave të përdoruesve vërehet që numri i kërkesave të përdoruesve në vitin 2017 është rritur duke arritur shifrën 776 kërkesa nga 509 kërkesa në vitin 2016. Pra, në ndryshim nga viti 2016 ku rënia e kërkesave ndaj 2015 ishte me 30,28 %, në vitin 2017 kemi një rritje të kërkesave me 52,5 % kundrejt vitit 2016. Nëse do të bënim specifikimin e mëtejshëm të këtyre kërkesave mund të themi që numrin më të madh të tyre e zënë kërkesat e statistikave të çmimeve me 102,7 % duke u pasuar nga

kërkesat e statistikave ekonomike 17,1 %, të dhëna nga statistika sociale me 48,3 %, statistikat mbi llogaritë kombëtare me 3 herë më shumë etj.

Figura 10: Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore.



Numrin më të madh të kërkesave të plotësuara në vitin 2017 e zënë statistikat e çmimeve me 298 kërkesa, pasuar nga statistikat ekonomike me 144 si dhe statistikat sociale me 132 kërkesa, etj. Një pasqyrë më të hollësishme mund ta konsultoni në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8: Numri i kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore

	2016		2017	
Kërkesat e përdoruesve	Numër	Përqindje	Numër	Përqindje
Stat. të Çmimeve	147	28,8	298	38,4
Stat. të Tregtisë së Jashtme	53	10,4	56	7,2
Stat. të Asn e prodhimi	8	1,5	10	1,3
Statistika të Turizmit e Transportit	30	5,8	43	5,5
Stat. popullsisë	32	6,2	55	7
Stat. të të ardhurave dhe të konsumit në familje	9	1,7	13	1,7
Stat. të tregut të punës	24	4,7	43	5,5
Stat. të Regjistrit të Ndërmarrjeve	29	5,7	20	2,6
Stat. Llogaritë Kombëtare	8	1,6	32	4,1
Stat. të Bujqësisë gjithsej	10	2,0	21	2,7
Kërkesa të dy a me shumë fushave statistikore	159	31,2	185	23,8
Gjithsej	509	100	776	100

Tabela 9: Kërkesat e detajuara të përdoruesve sipas temave, 2017

Lënda e Kërkesës	Numri i kërkesave
Çmimet	298
Bujqësia	21
Tregtia e jashme	56
Të dhëna të 2 ose më shumë fushave statistikore	59
ASN	10
Ndërmarrjet	20
Llogaritë kombëtare	32
Arsimi / lindjet-vdekjet / shkaqet e vdekjeve/ martesat-divorcet	12
Ndërtimi	11
Popullsia	55
Emigracioni	4
Punësimi / pagat	43
Turizmi / transporti / telekomunikacioni	43
Pyetësor të ndryshëm	8
Konsumi i familjeve / niveli jetesës	13
Aksidentet / krimet	4
Shëndeti, Sigurimet Shoqërore dhe Mbrojtja sociale / ndihma ekonomike	5
Feja dhe minoritetet	4
Kode / metodologji / publikime	15
Të tjera / të ndryshme	63
Totali	776

Rrjeti Social Facebook

Gjatë vitit 2017, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 4.497 pëlqime (në 2016 ishte 3590). Ku vlerën më të madhe e arrit gjatë muajve Nëntor - Dhjetor 2017.

Nga numri total i pëlqimeve, 57 % janë femra dhe 42 % janë meshkuj.

Postimet

Numri total i postimeve nga data 1 Janar 2017-31 Dhjetor 2017 është 220 (ndërkohë në periudhën 2016 ka qënë 150), postime të cilat kanë arritur një shikueshmëri prej 283.099 personash me një mesatare 1.287 për çdo postim. Postimet në faqe janë të bazuara në kalendarin e eventeve të facebook (duke respektuar kalendarin e publikimeve të INSTAT), i cili përmban datat e daljes së publikimeve dhe eventeve të tjera të rëndësishme. Statuset të cilat kanë pasur shikueshmërinë më të lartë janë:

1. Video - Video interaktive e Institutit të Statistikave (INSTAT) të Shqipërisë me statistikat kryesore në vend, datë 21/11/2017, ora 10:17 (74K) 195 Like 166 Share

<https://www.facebook.com/590804097669673/videos/vb.590804097669673/1443872895696118/?type=2&theater>

2. Postim - A e dini se në muajin Qershor 2017 hyrjet e shtetasve të huaj janë rritur me 11,0 %, ndërsa daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur me 2,9 % në krahasim me të njëjtin muaj të vitit 2016, datë 24/07/2017, (11.064 people) 3 Share
https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1341960772553998&id=590804097669673&substory_index=0

3. Video - INSTAT JU URON GËZUAR FESTAT, datë 29/12/2017 , ora 12:05 (7.846) 23 Share 69 Like

<https://www.facebook.com/590804097669673/videos/vb.590804097669673/1479280882155319/?type=2&theater>

4. Live stream-Dita Evropiane e Statistikave (LIVE) datë 20/09/2017 (7475 reach)
<https://www.facebook.com/590804097669673/videos/1415008225249252/>

5. Grafik - A e dini se në vitin 2016 sasia e qumështit, (7,456 People)
(<https://www.facebook.com/590804097669673/photos/a.601797059903710.1073741828.590804097669673/1324825610934181/?type=3&theater>)

6. Postim - Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, Znj. Delina Ibrahimaj, në Sesionin e 48 të Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara në mbështetje të projekt-rezolutës për forcimin e mbështetjes së rolit të Institutit të Statistikave në Sistemin Kombëtar Statistikor, date 08/03/2017, ora 15:17(5.834 people) 17 Share 94 likes

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1202340396516037&id=590804097669673

7. Video - Dita Botërore e Popullsisë. Si ka ndryshuar popullsia e Shqipërisë nga 1950 – 2011 (5827 people reach) 13 Share

<https://www.facebook.com/590804097669673/videos/1329085877174821/>

Mbulimi mediatik

Gjatë vitit 2017, në media të ndryshme, INSTAT është shfaqur 3.571 herë. Tematika më e përmendur në media është Llogaritë Kombëtare me 394 herë, ndjekur nga çmimet 320 herë, tregu i punës me 288 herë etj.

Tabela 10: Pasqyrimi i INSTAT në media

TEMA INSTAT	Totali
Llogaritë Kombetare	394
Çmimet	320
Tregu i Punës	288
Tregtia e Jashtme	245
Informacioni Ekonomik për Ndërmarrjet	216
Turizmi	216
Popullsia	211
Konsumi i Familjeve	160
Transporti	156
Aksidentet	153
Pagat dhe Kosto e Punës	144
Ndërtimi	106
Kultura	99
Bujqësia	86
Shëndeti dhe treguesit demografike	84
Arsimi	83
Mjedisi	82
Krimet	80
Energjia	78
Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve	78
Të Ardhurat e Familjes	78
Lejet e ndërtimit	54
Niveli i Jetesës	48
Census	39
Shpenzimet	34
Statistikat Financiare dhe Bankare	32
Postë-Telekomunikacion	7

Burimet njerëzore dhe financiare

Aktivitete të realizuara për vitin 2017

Miratimi i strukturës së re organizative me Urdhrin e Kryeministrit Nr.28, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave” i ndryshuar, bëri që Sektori i Burimeve Njerëzore gjatë periudhës prill-maj, të tremujorit të parë të vitit 2017 të fokusohej në finalizimin e procesit të ristrukturimit.

Në bazë të strukturës së re organizative, Instituti i Statistikave përbëhet nga 2 Koordinatorë, (Koordinatori i Sistemit Kombëtar Statistikor dhe Koordinatori për Cilësinë Statistikore), 9 drejtori, Sektori i Auditit të Brendshëm dhe 12 Zyrat Rajonale të Statistikave.

Për rregullimin e këtij detyrimi ligjor është punuar me kujdes nën udhëzimin e vazhdueshëm të DAP-it për të gjitha pozicionet e strukturës dhe plotësimin e tyre.

Struktura e re organizative ka në total 216 punonjës, 166 punonjës qendër dhe 50 punonjës në Zyrat Rajonale.

Në fund të vitit 2017, gjendja faktike në INSTAT kishte 185 punonjës në strukture dhe 31 pozicione vakante. Gjatë vitit 2017, janë rekrutuar nga jashtë Institucionit 19 punonjës.

Procesi i deklarimit të vendeve vakante, si rezultat i lirimeve, daljeve në pension etj., bëhet nga Sektori i Burimeve Njerëzore në fillim të vitit në aplikacionet përkatëse HRMS, si dhe në çdo kohë, rast pas rasti, deklarim që vijon më pas me procedurat e rekrutimit dhe emërimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike.

Si edhe në vitet e mëparshme, stafi i INSTAT-it përbëhet kryesisht nga gjinia femërore. Përqindja e vendit që zënë femrat është 70 %, kundrejt meshkujve me 30 %.

-Trajnimet e stafit

Gjatë vitit 2017, janë kryer 59 trajnime afatshkurtra nga të cilat 58 Trajnime ESTP dhe 1 Trajnim nga STAT CAB

-Numri i Stazhierëve

Gjatë vitit 2017, INSTAT ka pritur 7 stazhierë.

-Trajnime afatgjata

Gjatë vitit 2017, janë kryer 11 trajnime afatgjata nga të cilat 3 në periudhën 16.01.2017 - 16.06.2017 dhe 8 në periudhën 04.09.2017 - 15.12.2017.

-Punonjës me kontratë afatgjatë dhe me kontratë afatshkurtër

Gjatë vitit 2017, INSTAT ka patur 303 punonjës me kontratë afatgjatë në pozicionet kontrollor, kontrollor anketimi, operator dhe anketues. Numri i punonjësve me kontratë afatshkurtër ka qënë 1.780 të punësuar në pozicionet, anketues me kontratë shërbimi sipas anketave, kontrollor, kontrollor ankete dhe operator.

Figura 4: Përqindja e punonjësve të INSTAT sipas gjinisë





Figura 5: Punonjësit e INSTAT sipas grupmoshës për vitin 2017**Burimet Financiare**

Buxheti i Institutit të Statistikave për vitin 2017 i miratuar me ligjin nr.130/2016 është 396.600 mijë lekë.

Institutit të Statistikave i janë akorduar fonde shtesë në shumën 67 milion lekë për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore si rezultat i zbatimit të VKM Nr.187, datë 08.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukture dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil, Zv.ministrit dhe nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, të Aparateve të Ministrisë së Linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa Institucione të pavarura, Institucione në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit të Institucioneve në varësi të Ministrisë së Linjës dhe Administratën e Prefektit”, dhe VKM Nr.202, datë 15.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 717 datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe të nëpunësve të disa Institucioneve Buxhetore”, të ndryshuar.

Gjithashtu, INSTAT-it i janë akorduar fonde shtesë 6 milion lekë shpenzime operative, 678 mijë lekë nga fondi i veçantë dhe 20 milion lekë investime rimbursim TVSH-je për projektin IPA 2013, për përmirësimin e sistemit të informacionit statistikor si dhe për projektin Zhvillimi i infrastrukturës të IT të INSTAT.

Buxheti total i Institutit të Statistikave është 484.278 mijë lekë.

Këto fonde INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistike”.

Për periudhën Janar-dhjetor 2017 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 465.725 mijë lekë.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për periudhën Janar – Dhjetor 2017, krahasuar me planin vjetor paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Tabela 5: Shpenzimet, 2017

Art	Shpenzimet	VITI 2017			Real	Real
		PL Vjetor	PL I Rish	Fakt	PL.V %	PL.RV %
600	Paga	257.108	310.509	309.891	121	100
	Zyrat Rajonale	31.483	28.961	28.542	91	99
	Aparati Qendror nga buxheti	218.825	271.548	271.350	124	100
	Aparati Qendror nga të ardhurat	6.800	10.000	9.999	147	100
601	Kontribute sig shoq-shënd	47.192	54.791	51.527	109	94
	Zyrat Rajonale	5.277	4.919	4.799	91	98
	Aparati Qendror nga buxheti	40.775	48.202	45.202	111	94
	Aparati Qendror nga t137 ardhurat	1.140	1.670	1.526	134	91
602	Mallra dhe shërbime të tjera	84.286	90.286	84.510	100	94
	Zyrat Rajonale	5.807	5.167	4.203	72	81
	Aparati Qendror nga buxheti	70.819	66.859	62.327	88	93
	Aparati Qendror nga të ardhurat	7.660	18.260	17.980	235	98
604	Transferime korente	1.014	1.014	215	21	21
	Aparati Qendror nga buxheti	1.014	1.014	215	21	21
606	Transferime buxhetesh familjare		678	678		100
	SHUMA	389.600	457.278	446.822	115	98
	Investime Aparati Qendror	7.000	27.000	18.903	270	70
230	Shpenz për rritjen e AQ të part Buxheti					
231	Shpenz për rritjen e AQ të trup Buxheti	7.000	27.000	18.903	270	70
	TOTALI	396.600	484.278	465.725	117	96

Sic shihet nga pasqyra, në artikullin 600, paga (që zë rreth 64 % të buxhetit) janë shpenzuar 309.891 mijë lekë, e barabartë kjo me 99,8 %, krahasuar me planin vjetor.

Në artikullin sigurime shoqërore e shëndetsore janë shpenzuar 51.527 mijë lekë, e barabartë kjo me 94 %, krahasuar me planin vjetor.

Në zërin mallra dhe shërbime të tjera, për vitin 2017 janë shpenzuar 84.510 mijë lekë, e barabartë kjo me 94 %, krahasuar me planin vjetor. Ky mos realizim ka ardhur nga mos kalimi nga dega e thesarit të urdhër shpenzimeve të dërguara me datë 29.12.2017 në shumën rreth 4 milion lekë.

Në zërin transferime korente, për vitin 2017 janë shpenzuar 215 mijë lekë, nga 1.014 mijë lekë të planifikuara e barabartë kjo me 21 %.

Në zërin transferime buxhetesh, për vitin 2017 janë shpenzuar 678 mijë lekë, e barabartë kjo me 100 %.


Në zërin investimet janë shpenzuar 18.903 mijë lekë e barabartë kjo me 70 % e krahasuar me planin vjetor. Ky mos realizim ka ardhur kryesisht në zërin rimbursim tvsh si rezultat i mos zhvillimit të tenderave për projektin “Zhvillimi i infrastrukturës të IT të INSTAT” me donatorë SIDA.

Tabela 6: Realizimi i shpenzimeve krahasuar me planin vjetor sipas zërave

Art	Shpenzimet	Plani Vjetor	Fakt	Realizimi PL.Vjetor%
600	Paga+sigurime	365.300.0	361.418.3	99
602	Mallra dhe shërbime të tjera	91.978.0	85.404.0	93
	SHUMA	457.278.0	446.822.3	98
231	Shpenz për rritjen e AQ të trup Buxheti	27.000.0	18.903.0	70
	TOTALI	484.278	465.725	96

Siç shikohet nga të dhënat e tabelës, plani i shpenzimeve të buxhetit në artikullin 600 (paga dhe sigurime) që zë rreth 75 % të tij është realizuar 99 %, në artikullin 602 shpenzime të tjera korrente është realizuar 93 % dhe në artikullin 231 shpenzime për investime është realizuar 70 % shpenzimet totale janë realizuar 96 %, në krahasim me planin vjetor.

Figura 6: Shpenzimet, 2017



Kontaktet e institucionit



INSTAT - Instituti i Statistikave

Bul."Zhan D'Ark", Nr .3 Tiranë, Shqipëri

Tel+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356

Fax+(355) 4 2228300

www.instat.gov.al

info@instat.gov.al